



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 maj 2015
Nr. ref.: RK 802/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI09/15

Parashtrues

Ramë Dauti

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës PML. nr. 205/2014, të 19 nëntorit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama- Hajrizi, gjyqtare, dhe
Bekim Sejdiu, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Ramë Dauti me vendbanim në Viti (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati z. Rifat Abdullahi.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës PML. nr. 205/2014, të 19 nëntorit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyqimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [PML. nr. 205/2014] të 19 nëntorit 2014, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me Kushtetutë, dhe atë: neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 6 dhe neneve 2 dhe 4 të Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Të njëjtën ditë, parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë Masën e përkohshme dhe të nxjerrë vendim të veçantë me të cilin do të shtyhej përmbarimi i aktgjyqimit të formës së prerë derisa të vlerësohet kushtetutshmëria e aktgjyqimit të kontestuar.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 54, 55 dhe 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 29 janar 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 9 shkurt 2015, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KIO9/15, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KIO9/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
8. Më 25 shkurt 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën Supreme në lidhje me regjistrimin e kërkesës.
9. Më 16 prill 2015, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës, dhe refuzimin e kërkesës për Masë të përkohshme.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 26 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi kallëzim penal kundër gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Kamenicë, për veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare ose autorizimit.

11. Më 28 mars 2011, Prokuroria Publike Komunale në Gjilan e refuzoi këtë kallëzim penal, njëkohësisht ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës për veprën penale lajmërimet e rrejtshme nga neni 306, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK).
12. Më 28 prill 2014, Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, nxori Aktgjykimin [P. nr. 462/2013] me të cilin e dënoi parashtruesin e kërkesës me burgim prej 40 ditësh.
13. Parashtruesi i kërkesës në afatin ligjor ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjyimit të Gjykatës Komunale në Gjilan - Dega në Kamenicë [P. nr. 462/2013], për shkak të shkeljeve të dispozitave të KPK dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.
14. Më 21 gusht 2014, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin [PA1. nr. 802/14] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar me arsyetimin se: *„Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e larte cekura nuk janë të bazuara. Aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.12 dhe par. 2 lidhur me nenin 370 par. 7 të KPP-së për të cilat pretendohet në ankesë dhe as shkelje tjera të cilat kjo gjykate i vëren çdo here sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 të KPP-së. Aktgjykimi është konkret dhe i qartë,...*“.
15. Parashtruesi në afatin ligjor dorëzoi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë [P. nr. 462/2013], të 25 prillit 2014, dhe Aktgjyimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë [PA1. nr. 802/2014], të 21 gushtit 2014.
16. Më 19 nëntor 2014, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [PML. nr. 205/2014], me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtjen e ligjshmërisë si të pabazuar me arsyetimin se: *“Lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par. 7 të KPPK si dhe nenit 361 par. 2 të KPPK, në kërkesë nuk është precizuar se ku dhe në çfarë manifestohen këto shkelje. Megjithatë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të qarta dhe konkrete, në arsyetimet e tyre janë dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *„se me vendimet e Gjykatave të rregullta ndaj tani të dënuarit janë shkelur të drejtat kushtetuese (te drejtat e te akuzuarit nga neni 30 dhe e drejta për Gjykim të drejtë dhe të paaneshëm nga neni 31 i Kushtetutes së Republikës së Kosovës dhe dispozitat e nenit 6 dhe nenet 2-4 të protokollit 7 të Konventës Evropiane mbi të drejtat Themelore të njeriut”*.
18. Parashtruesi kërkon nga Gjykata:

”I. TË SHPALL, Kërkesen të pranueshme.

- II. *KONSTATON se ka patur shkelje te nenit 30 (te drejttat e te akuzuarit) dhe nenit 31 (E drejta per gjykim te drejte dhe te paaneshem);*
- III. *ANULOHEN aktgjykimet e Gjykares Supreme te Kosoves PML. nr. 205/2014 dt. 19.11.2014, Aktgjykimi i Gjykares se Apelit te Kosoves PA1. nr. 802/14 dt. 21.08.2014 dhe aktgjykimi i Gjykares Themelore ne Gjilan - Dega ne Kamenice P. nr. 461/2013 dt. 25.04.2014;*
- IV. *Lenda i kthehet Gjykares se shkalles se pare ne riprocedure, por duke e deleguar kompetencen reale ne nje Gjykares tjeter Themelore“.*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Në mënyrë që të jetë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, neni 113. paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

21. Neni 48 i Ligjit përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

22. Gjykata gjithashtu i referohet rregullave 36 (1) (d), 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, të cilat përcaktojnë:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...], ose

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij“.

23. Në rastin konkret, parashtruesi në kërkesë theksoi që me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës [PML. nr. 205/2014] të 19 nëntorit 2014, janë shkelur të drejtat dhe liritë kushtetuese nga neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës së

Republikës së Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 6 dhe të neneve 2 dhe 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së.

24. Në lidhje me këtë, Gjykata e ka shikuar tërë procedurën para gjykatave të rregullta si një tërësi, dhe konsideron se procedura është kryer në atë mënyrë që parashtruesit i është dhënë e drejta për gjykim të drejtë, gjë që Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj [PML. nr. 205/2014] konkludoi: „[...] aktgjykimi i gjykatës se shkalles se pare dhe ai i shkalles se dyte janë të qarta dhe konkrete, në arsyetimet e tyre janë dhënë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante“.
25. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar që të ketë mbrojtësin që të paraqesë mbrojtjen e tij, të marrë pjesë në procedurë, të ndjek rrjedhën e procedurës, të shterë mjetet juridike dhe të ndër marrë veprime të tjera ligjrisht të lejuara procedurale, si dhe nga arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Supreme [PML. nr. 205/2014] rezulton se të gjitha kundërshtimet e tij ishin të pabazuara, dhe se nuk kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve të marra mbi përgjegjësinë penale. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, në ankesën kushtetuese nuk ka specifikuar asnjë arsye në bazë të cilës do të mund të vërtetohej se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme dhe mundësi për përgatitjen e mbrojtjes.
26. Nga se u tha më lart, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe të nenit 6 dhe neneve 2 dhe 4 të Protokollit 7 të KEDNJ-së, janë të pabazuara.
27. Gjykata rikujton se neni 53 i Kushtetutës [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] parasheh që: *“të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut”*.
28. Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i këtyre të fundit që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, GJEDNJ Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih edhe Aktvendimi për papranueshmëri në Rastin nr. 70/11, parashtruesit *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, të 16 dhjetorit 2011).
29. Gjykata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. Nr. 13071/87, 10 korrik 1991).
30. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ (Shih, Rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit *Tafil Qorri dhe Mehdi Sylja*, Gjykata Kushtetuese e Republikës Kosovës, Vlerësimi i kushtetutshmërisë së

Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 1947/2013, të 5 dhjetorit 2013).

Vlerësimi i kërkesës për Masë të përkohshme

31. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë kërkon që Gjykata të vendosë Masën e përkohshme dhe të nxjerrë një vendim të veçantë me të cilin do të shtyhet përmbartimi i aktgjykimit të formës së prerë, derisa të vlerësohet kushtetutshmëria e aktgjykimit të kontestuar.

32. Për të aprovuar Masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) të Rregullores së punës, Gjykata duhet të përcaktojë:

“(a) pala që kërkon Masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon Masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të riparueshme nëse nuk lejohet Masa e përkohshme.

[...]“

33. Siç u konkludua më lart, kërkesa është e papranueshme, prandaj nuk ka rast *prima facie* për vendosjen e Masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për Masë të përkohshme duhet të refuzohet.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me rregullat 36 (1) (d) dhe 36 (2), 55 (4) (a) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 maj 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve dhe ta publikojë këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani